



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I ARKEOLOGJISË DHE TRASHËGIMISË KULTURORE

PROGRAMI I LËNDËS
Drejtimi : Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore
TITULLI I LËNDËS: HYRJE NË ARKEOLOGJI

Pedagogu: Prof. Dr. Iris Pojani
Ngarkesa: 6 ECTS (45 leksione dhe 15 seminare)
Lloji i lëndës: disiplinë e formimit të përgjithshëm (bazë)
Programi i studimit: Bachelor
Viti/Semestri: I/I

EKSTRAKT

Hyrja në arkeologji përpqet të japë njohuritë bazë për një nga disiplinat shkencore më aktive në lëvrimin e historisë së gjatë të shoqërisë njerëzore. Nëpërmjet leksioneve gjerësisht të ilustruara dhe diskutimeve në klasë do të përcillen konceptet me të cilat operon arkeologjia, historia e zhvillimit të saj si shkencë, metodat kryesore të studimit dhe roli e vendi i saj në shoqërinë e sotme. Një nga objektivat kryesore të lëndës është edhe orientimi i studentëve për karrierën potenciale profesionale në këtë fushë të aplikuar të studimit.

Objektivat e lëndës do të realizohen nëpërmjet mësimdhënies formale në klasë, diskutimit në seminare, por edhe nëpërmjet disa vërtetimeve praktike dhe vizitave në muzetë dhe projektet arkeologjike në terren. Përveç informacionit të përditësuar për zbulimet dhe debatet e fundit në arkeologjinë botërore dhe atë shqiptare, leksionet do të trajtojnë edhe temën e ruajtjes dhe administrimit të pasurisë arkeologjike si një nga kontributet e disiplinës në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të shoqërisë bashkëkohore.

TEMAT:

LEKSION 1. Hyrje. Ç'është dhe çfarë nuk është arkeologjia.

LEKSION 2. Origjina dhe zhvillimi i arkeologjisë. Historia e arkeologjisë shqiptare.

LEKSION 3. Konceptet bazë të arkeologjisë.

LEKSION 4. Ruajtja e të dhënave, procesi i formimit të tyre dhe vrojtimi arkeologjik.

LEKSION 5. Gërmimi arkeologjik dhe procesi i pas-gërmimit.

LEKSION 6. Datimi dhe kronologjia.

LEKSION 7. Përmasat e arkeologjisë: koha dhe hapësira.

LEKSION 8. Mjedisi dhe vendbanimet.

LEKSION 9. Mënyra e jetesës: teknologjia dhe këmbimi.

LEKSION 10. Njeriu dhe shoqëria.

LEKSION 11. Arkeologjia e mendjes.

LEKSION 12. Interpretimi arkeologjik. Spjegimi i vazhdimësisë dhe ndryshimit.

LEKSION 13. Ruajtja, administrimi dhe prezantimi i pasurisë arkeologjike.

LEKSION 14. Vizitë në Muzeun Arkeologjik/Muzeun Historik Kombëtar, Tiranë.

LEKSION 15. E sotmja dhe e ardhmja e arkeologjisë.

FORMA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT

FREKUENTIMI:

70% pranisë në seminare e domosdoshme.

15 % e notës përfundimtare nga prania dhe angazhimi gjatë kursit apo seminareve

KONTROLLI I VAZHDUESHËM:

Testi 1 i pjesshëm në javën e 6-të (10% e notës përfundimtare)

Testi 2 i pjesshëm në javën e 10-të (15% e notës përfundimtare)

25 % e notës përfundimtare.

DETYRA E KURSIT:

Detyrë kursi ose konspekt i një teksti apo autori ose ese nga 3- 5 faqe format A4, Times Neë Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5)

20 % e notës përfundimtare

KONTROLLI PËRFUNDIMTAR:

Një test përfundimtar në javën e 16-të të kursit pas kryerjes së 15 javëve të një semestri

40 % e notës përfundimtare

LITERATURA

1. Bahn, P. 2000 *Archaeology: a very short introduction*. Oxford University Press, Oxford.
2. Bejko, L. 1998 “Vështtrim mbi mendimin arkeologjik shqiptar dhe kontekstin e tij social”, në *Iliria* 1-2.
3. Ceka, N. dhe M. Korkuti 1998 *Arkeologjia*. Shtëpia Botuese “Libri Universitar” (shblu), Tiranë.
4. Fagan, B. 1983 *Archaeology: a brief introduction*. Little Brown & Co., Boston-Toronto. Second edition.
5. Gamble, C. 2008 *Archaeology: the basics*. Routledge, London and New York. Second edition.
6. Renfrew, C. dhe P. Bahn 2008 *Archaeology: theories, methods and practice*. Thames & Hudson, London. Fifth edition.